



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.11.2023

Nr: 191

Ora: 11:00

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 95, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 16.11.2023
NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.11.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Koli	BELE	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar me autorizim të posaçëm nga av. Arben Llangozi, av. Franci Nuri dhe av. Altin Kaziaj

OBJEKT: Ankim kundër vendimit të "KQZ" rrëzimin e kërkesës së Koalicionit "Bashkë Fitojmë" për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës. Në lidhje me shqyrtimin e projektvendit *"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues"*

z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008
"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Koalicioni Bashkë Fitojmë ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 95 regj., datë 16.11.2023.

Në mbledhjen e datës 23.11.2023, ora 11:00, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht ankimi duhet të depozitohet nga partia politike, pasi me certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, koalicionit i ka përfunduar personaliteti juridik. Gjithashtu afati i ankimit ndaj vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përfundon në datën 14.12.2023. Në këto kushte KAS-i do të respektojë afatet procedurale, pasi mund të këtë interes të ligjshëm nga subjekte të tjera për të ankimuar këtë vendim dhe mund të bashkohen në një shqyrtim të vetëm.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjës "b" dhe "dh" të pikës 1, të nenit 126, të Kodit Zgjedhor, ajo duhet t'i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 95, datë 16.11.2023 për plotësim të elementëve të formës brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 18.12.2023, ora 11:00.

Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraparak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 23.11.2023.

Elvin LAKO - Relator

Koli BELE - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar